



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 17 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.nr. 16-126211 datë 06.11.2014, dhe në zbatim të Rekomandimit të Komitetit për Politike dhe Financa, 01.nr.151/2017 të datës 07.09.2017, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur më 18.09.2017, merr

VENDIM

Për miratimin e Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Gjiçanit 2017-2021

1. Me këtë vendim miratohet Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Gjiçanit për periudhën 2017-2021 i cili është produkt i punës së përbashkët të Drejtorisë Komunale të Arsimit – Gjiçan dhe Rrjetit Kosovar për Arsim dhe Punësim (KEEN), koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale dhe i cili është hartua përmes një procesi të strukturuar dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, duke u mbështetur në nevojat reale për zhvillimin e arsimit në Komunën e Gjiçanit, si dhe në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Gjiçanit për periudhën 2017-2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim. përderisa për implementimin e tij do të kujdeset Kryesuesja e KK-Gjiçan.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.016-97316
Gjiçan, më 18.09.2017

Kryesuesja e Kuvendit

/Shpresa Kurteshi/